

PROKURORIA E SHTETIT
DRŽAVNO TUŽILAŠTVO KOSOVA
A nr.br.no. 90/10,
Dt. 04.06.2010
PRISHTINE-PRISHTINA



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. _____
Dep. 2-D
Nr. Prot. _____
Br. Prot. 01-2209/10
Prot No. _____
Data _____
Datum 04-06-2010
Date _____
Nr. I faq. _____
Broj stranica _____
Nr. pages _____
PRISHTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO



PROKURORIA E SHTETIT
DRŽAVNO TUŽILAŠTVO
STATE PROSECUTOR

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES TË

PROKURORISË SË SHTETIT DHE AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit pajtohen si në vijim

1

Prokuroria e Shtetit dhe Agjencia Kundër Korrupsionit krijojnë raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në luftimin e korrupsionit përmes:

- Shkëmbimit të informacioneve lidhur me korrupsionin;
- Bashkëpunimit në hetimin e rasteve që rezultojnë me veprime kriminale të korrupsionit;
- Ndihmën dhe asistencën teknike të ndërsjellë në proceset hetimore;
- Ofrimin e këshillave të ndërsjella në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit.

2

Agjencia Kundër Korrupsionit do të këtë të drejt të dërgojë kallëzime penale për vepra penale me natyrë korruptive në Prokurorinë e Shtetit dhe do të ofroj ndihmën e saj në hetimin e këtyre veprave.

3

Në rastet kur Agjencia parashtron kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit, kallëzimet penale do të dërgohen te prokuroritë kompetente për qëllime hetimore dhe për të njëjtat Agjencia kundër Korrupsionit do të informohet përmes Drejtorit të saj dhe me kërkesë të tij/saj në lidhje me trajtimin e kallëzimeve penale të dërguara nga Agjencia Kundër Korrupsionit përmes informatave kthyesë të cilat duhet të përmbajnë numrin e referencës të Agjencisë.

4

Prokuroria e Shtetit në çdo kohë mund të kontaktoj me Agjencinë kundër Korrupsionit dhe të kërkojë ndihmën e saj në trajtimin e kallëzimeve penale të dërguara nga Agjencia.

5

Prokuroria e Shtetit dhe Agjencia kundër Korrupsionit do të bashkëpunojnë ngushtë gjatë hetimit të rasteve të dyshuara për korrupsion të cilat i dërgon Agjencia në Prokurori, duke përfshirë këtu edhe dhënien e autorizimeve nga Prokuroria për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara hetimore nga Agjencia për Prokurorinë.

6

Agjencia Kundër Korrupsionit, çdo herë kur ta shoh të nevojshme, mund të kërkojë ndihmën e Prokurorisë në sigurimin e dokumentacionit të kërkuar nga institucionet, në rastet kur këto të fundit refuzojnë që ta dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar nga Agjencia, sidomos kur kjo ka të bëjë me sigurimin e dokumentacionit financiar nga ana e bankave për personat fizik dhe juridik që janë objekt i hetimit.

7

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje pajtohen që të zgjerojnë fushën e bashkëpunimit në luftimin e korrupsionit edhe përmes formave të tjera si:

1. Trajnimet e përbashkëta;
2. Pjesëmarrja në seminare të përbashkëta;

8

Palët nënshkruese pajtohen të bashkëpunojnë plotësisht në realizimin e pikave që dalin nga neni 5 i Ligjit nr. 03-L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe kapitulli XXIX i Kodit Penal të Kosovës, nga secila palë nënshkruese e kësaj marrëveshje që iu takon konform akteve ligjore të cekura më lart.

9

Parimet e ruajtjes së konfidencialitetit të informatave dhe dokumenteve të kësaj natyre, do të zbatohet me përpikëri në mes të palëve nënshkruese. Ky obligim shtrihet në parandalimin e pengimit të çfarëdo forme të veprimit që mund të shkaktojë konflikt të kompetencave në mes të palëve nënshkruese, më përjashtim të rasteve kur kjo është e nevojshme për përmbushjen e mandatit të Prokurorisë.

Bashkëpunimi do të realizohet në mes të zyrtarëve përkatës kontaktues si dhe në pajtueshmëri të plotë me zotimet që dalin nga kjo Marrëveshje.

11

Asnjë nga veprimet e cekura më lart, që adresojnë format e bashkëpunimit ndër-institucional nuk guxojnë të përdoren për qëllime tjera, nuk mund të publikohen për shkak se një gjë e tillë do të dëmtonte procesin e hetimeve.

12

Kjo Marrëveshje shfuqizohet:

- a. Me paralajmërim nga njëra palë në afat prej 30 ditësh
- b. Automatikisht nëse shkelen dispozitat e Marrëveshjes.

13

Rishikimi i bashkëpunimit dhe raportimi i të arriturave do të bëhet në çdo fund-vit kalendarik përmes takimit të rregullt që do të mbahet në mes të menaxhmentit përkatës të institucioneve nënshkruese të kësaj marrëveshje.

14

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Kryeprokurori i Shtetit dhe Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit.

Marrëveshja e Bashkëpunimit i dorëzohet:

- 2 x Prokurorisë së Shtetit
- 2 x Agjencisë Kundër Korrupsionit

Prokuroria e Shtetit
Kryeprokurori i Shtetit


Ismet Kabashi



Agjencia kundër Korrupsionit
Drejtori


Hasan Preteni



Prishtinë, d.t: 04.06.2010